



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.10.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:06 dhe mbaroi në orën 11:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 8. Përfaqësues të ILD-së.*
- 8. Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Siç jeni në dijeni, në këtë rend dite janë 9 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe konkretisht, çështja e parë ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë”. Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin për emërim të kandidatës së diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, znj. {...}”.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe civile, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e pestë është shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe civile, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e gjashtë është shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e shtatë është shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 85, datë 26.02.2020 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, shpallur me vendimet nr. 242 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e tetë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e fundit është shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dy pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 88 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Jeni dakord me rendin e ditës?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që siç jeni në dijëni, ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Ftojme palët në këtë proces.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes magjistrati, z. {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Periand Teta.)

Naureda Llagami: Atëherë, duke qenë se palët janë akomoduar në sallë, deklaroj të hapur seancën dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}.

Kjo seancë dëgjimore është publike në përputhje me nenin 142 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe për këtë qëllim janë ftuar për të ndjekur në kohë reale përfaqësues të medias së shkruar dhe vizive, prezenca e të cilëve do të mundësohet nëpërmjet platformës “online”, duke respektuar protokollin e COVID-19.

Pa humbur kohë kalojmë në verifikimin e prezencës së palëve.

Nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka ardhur Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani.

Artur Metani: Po! – dhe Këshilltari im, Periand Teta.

Naureda Llagami: I shoqëruar nga z. Periand Teta.

Ndërkohë, ka ardhur vet gjyqtari procedues, z. {...}.

{...}: Po! – konfirmoj prezencën.

Naureda Llagami: Atëherë, më lejoni t’ju informoj se me shkresën nr. 249/2, datë 18.09.2020, nga ana e KLGJ-së i është njoftuar gjyqtarit procedues, z. {...} vendimi i KLGJ-së nr. 334, datë 17.09.2020 për zgjatjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së ILD-së

për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij, si dhe caktimin e datës 2 tetor 2020 si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore. Njëkohësisht me këtë njoftim, sipas nenit 141, paragrafi 2 të ligjit nr. 96/2016 për Statusin, i ndryshuar, subjektit i janë bërë të ditura të drejtat e tij në këtë procedim, duke i lënë edhe një afat deri më 28.09.2020, për të paraqitur parashtrësat me shkrim.

Nga ana tjetër, rezulton se deri tani, nga palët në proces, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e ndonjë anëtari të KLGJ-së nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative në fazën paraprake, me argumentin se ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. E njëjta gjë vlen edhe për anëtarët e KLGJ-së të cilët nuk kanë deklaruar deri tani se kanë pengesë ligjore apo konflikt interesi për të marrë pjesë në këtë procedim.

Gjithashtu, dëshiroj t’ju bëj me dije se pas komunikimeve që kemi pasur me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur si standard që dosja me aktet origjinale të subjektit, të paraqitet dhe të depozitohet pranë KLGJ-së.

Jo më larg se data 01.10.2020, kjo dosje i është përcjellë KLGJ-së ku rezulton se aktet origjinale të administruara, janë të njëjta me ato që është njohur edhe subjekti.

Vijojmë më tej. Unë do doja të dija nga ana e palëve që kanë të drejtë të parashtrajnë kërkesa procedurale paraprake që lidhen me legjitimitetin apo me zhvillimin e procesit të rregullt ligjor.

Artur Metani: Jo!

{...}: E nderuar Kryetare, unë kam.

Siç edhe jeni në dijeni, kam komunikuar me këtë Këshill të nderuar me aktin nr. 2 prot., datë 21 shtator 2020 të gjyqtarit, një ankesë procedurale të magjistratit {...}. Nuk e di nëse e dispononi apo jo?!

Është komunikuar në rrugë postare dhe në rrugë elektronike.

Jam ankuar ndaj mosveprimit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për mosvendosjen në dispozicion të magjistratit të raportit përfundimtar të këtij procedimi disiplinor. Është paraqitur ankesa edhe ndaj mosveprimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

për moskomunikim të këtij raporti gjyqtarit, pra në thelb lidhur me cilat janë faktet/rrethanat objekt akuze, në qoftë se mund të shprehem kështu, pra cilat kanë qenë shkeljet disiplinore për të cilat ndodhem në këtë procedim disiplinor, pasi, deri në këto momente që ndodhem përpara jush, unë nuk kam asnjë komunikim zyrtar të këtij akti.

Kërkesa e dytë ka të bëjë me atë me nr. 3 prot., datë 27 shtator 2020, të cilën jua kam komunikuar edhe në rrugë postare edhe në rrugë elektronike, për shkak të karakterit të procesit, kam kërkuar caktimin e një përkthyesi apo disa përkthyes, për të përkthyer një numër aktesh që i takojnë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (janë vendimmarrje gjyqësore), si dhe dy prej tyre i takojnë Gjykatës së Hagës, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë shqyrtim të procedimit disiplinor. Kam paraqitur edhe arsyet përkatëse përse e kërkoj këtë.

Kam kërkuar thirrjen me cilësinë e dëshmitares të shtetasës znj. Etilda Gjonaj, me detyrë Ministre e Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, për të qenë e pranishme në shqyrtimin gjyqësor të dy prej akteve, që i kam paraqitur si provë, të cilat kanë të bëjnë me vendimmarrjen e dy gjykatave hierarkike të Hagës.

Kam kërkuar administrimin e plotë të akteve të dosjes që administrohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, përkatësisht Komisioni për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, proces i cili ka përfunduar me marrjen në mbrojtje të fëmijëve të gjyqtarit {...} për një periudhë dymujore.

E vlerësoj shumë të rëndësishme që këto kërkesa të plotësohen. Por pikësëpari, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor kërkoj që nga ana e Këshillit të lartë Gjyqësor të trajtohet dhe shqyrtohet problematika që lidhet me moskomunikimin e fakteve dhe rrethanave për të cilat ndodhem në këtë procedim disiplinor, me të cilën janë njohur vetëm më datë 22 shtator, jo me komunikim të drejtpërdrejtë të raportit përfundimtar të ILD-së, por e kam gjetur këtë raport në përmbajtje të akteve të materialeve të këtij procesi disiplinor, si e drejtë për njohjen me to. Pra nuk kam asnjë komunikim të drejtpërdrejtë të fakteve dhe rrethanave për të cilat ndodhem në procedim disiplinor. Asnjë akt nuk e vërteton që ky akt është më është komunikuar.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Artur Metani: E nderuar Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Sa i kërkon kësaj kërkesë të parë, mendoj që nuk qëndron, pasi në kuptimin e plotë të fjalës, magjistrati ka qenë në dijeni të çdo hapi të hedhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë që në datën 22 prill kur ka filluar proceduralisht hetimi ndaj magjistratit.

Sa i takon përfundimit të hetimit dhe dërgimit të çështjes në KLGJ, magjistrati është njoftuar për vendimin dhe jo për materialin dhe kjo ka një arsye. Ka një arsye sepse detyrimi ligjor nuk qëndron për ILD-në ta njoftojë magjistratin për përfundimin apo për raportin e hetimit të përfunduar, por vetëm për përfundimin dhe arkivimin e çështjes. Dhe ka një arsye kjo. Ka një arsye që është Kushtetuese - sipas mendimit tim - sepse në momentin që përfundon hetimi disiplinor, çdo kompetencë apo çdo çështje të menaxhimit të situatës së çështjes e merr vet KLGJ-ja, dhe ILD-ja është i barabartë me magjistratin në çdo proces të mëtejshëm mbas këtij momenti.

{...}: Mundem, ju lutem?

Në qoftë se mundem?

Nuk jam dakord me pretendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Është e vërtetë që më është komunikuar fillimi i hetimit disiplinor.

Në mënyrë të menjëhershme i jam drejtuar duke kërkuar plotësimin dhe sqarimin e aktit me nr. 313/7 prot., të datës (data është e korrigjuar) 1 ose 2 prill 2020, material të cilin e keni sepse e kam bërë për dijeni edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në vendimin për fillimin e hetimit të procedimit disiplinor nuk kam qenë absolutisht në gjendje të kuptoj për të cilat qenë arsyet që është filluar hetimi disiplinor dhe i kam kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të më sqarojë, duke drejtuar një numër pyetjesh, për të qenë i qartë lidhur me situatat të cilat do të trajtoheshin nga ky Inspektorat.

Përveç kërkesës për të më vënë në dispozicion se çfarë provash kishte në dispozicion Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, që lidheshin kryesisht me provat që ishin paraqitur nga kallëzuesi për fillimin e këtij procedimi disiplinor (Ministrja e Drejtësisë), asnjë prej situatave juridike, të cilat kam kërkuar të sqarohen, nga parimi që pyetjet mund

të jenë po dhe aq të mira - normalisht janë më të mira se përgjigjet - nuk kam gjetur asnjë sqarim të këtyre kërkesave.

Në situatën që parashikon ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çdo kërkesë që paraqet magjistrati, edhe kur nuk ka formën e një ankese, konsiderohen nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor si ankesë, pavarësisht titullit apo përmbajtjes së saj.

E vlerësoj plotësisht të papranueshme, që nga ana e Inspektoratit nuk më është sqaruar asnjë prej fakteve dhe rrethanave që kam kërkuar të qartësohem. Është parimi i një procesi të rregullt ligjor që, personi i cili ndodhet në një shkelje të caktuar, siç është kjo disiplinore, duhet të jetë i qartë lidhur me përmbajtjen dhe arsyet e shkeljes, dhe ku mbështetet ajo. Që në momentin e fillimit të hetimit disiplinor, natyrisht nuk kam kërkuar, po t’i referohemi përmbajtjes së aktit (kërkesës sime), që Inspektorati i Lartë i Drejtësisë të më jepte një përgjigje definitive sepse jemi në fillimet e hetimit, por kam kërkuar thjesht sqarime se ku mbështetet Inspektorati lidhur me ato që parashtronte dhe për më tepër, se cilat ishin faktet dhe rrethanat konkrete të cilat do t’i nënshtroheshin hetimit të çështjes në kuadër të këtij procedimi disiplinor.

Siç rezulton pastër nga përmbajtja e kërkesës dhe aktit të fillimit të hetimit disiplinor, që më është komunikuar, veçse një parashtrimi të ankësës së Ministres së Drejtësisë, të disa pikave në përmbajtje të vendimit të vendimit gjyqësor që ka cenuar vendimin objekt procedimi disiplinor të Gjykatës së Apelit Korçë, nuk ka asnjë analizë apo referencë. Janë thjesht, mungon fakti, mungon konkluzioni, mungon dhe konkludimi mbi faktin.

Po çfarë është më thelbësore? – vazhdoj ta përsëris - kam vënë në dukje se citim i Gjykatës së Apelit përmbante 9 pika. Ndërkohë që në qëndrimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, këto përmbledheshin vetëm në 4 pika, të cilat nuk kishin lidhje tërësisht në të gjithë arsyet e cituara për shkaqet e prishjes së vendimit të magjistratit {...} nga ana e Gjykatës së Apelit Korçë.

Kam vlerësuar se kjo situatë procedimore nuk ishte normale pasi të gjitha “faktet” që mu relatuan për fillimin e hetimit disiplinor kishin një natyrë thellësisht paragjyquese

(mund të konstatohet fare objektivisht), në mungesë të argumentit dhe problematika të tjera që kam trajtuar në përmbajtje të kësaj kërkesë.

Do më falni, do zgjatem edhe shumë pak. Duke qenë se jemi në këtë fazë të kërkesave paraprake, ILD në raport, këto pyetje të gjyqtarit i ka konsideruar si parashtrësë. Nuk është absolutisht e vërtetë që kjo është parashtrësë. Nuk ka asnjë ndërveprim të ILD-së me personin tim në detyrë, për sqarimin e rrethanave të çështjes.

Duke tërhequr vëmendjen tuaj si Këshill se, konkluzionet në të cilat mbështetet Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, që kam qenë emocional, emotiv, hipotetik, nuk e di, pas zgjidhshmërisë si rezultat i këtij procesi duhet të lidheshin drejtpërdrejt me pyetjen time si magjistrat. Nuk e kuptoj për çfarë arsye dhe pse ishin gjërat kaq të qarta sa nuk është ndërmarrë, në kuadër të fillimit të hetimit disiplinor dhe në kuadër të hetimit të këtij procesi disiplinor gjatë fazës së ILD-së, nuk jam thirrur asnjëherë nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë. Pra edhe një herë theksoj faktin dhe kërkoj të shënohet dhe të mbahet parasysh që ILD-ja në raport parashtron që është komunikuar me gjyqtarin, i cili ka kthyer përgjigjen me shkresën nr. aq dhe kaq, ndërkohë që nuk është parashtrësë dhe nuk është kthim përgjigje. Është thjesht një kërkesë për të cilën kam kërkuar që të sqarohem, për aq sa ishte e mundur, lidhur me përmbajtjen e fakteve dhe rrethanave të kundërligjshme.

Prej këtij momenti, nuk ka asnjë komunikim me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë për këtë aspekt procedural në çështjen që lidhet me thelbin, në sqarimin e rrethanave dhe bashkëveprimit dhe ndërveprimit me magjistratin. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti {...}!

Atëherë, me sa dijeni kemi nga aktet e administruara në dosje, rezulton që ju janë komunikuar të gjithë aktet, duke përfshirë edhe arsyet dhe shkaqet që Inspektori i Lartë i Drejtësisë ju ka parashtruar. Pra nuk më rezulton që nga ana e Këshillit nuk ju janë parashtruar të gjitha shkaqet dhe arsyet për fillimin e këtij procedimi disiplinor. Kështu që, unë mendoj që këto lloj çështjesh që ju ngrini janë çështje të cilat ne duhet t'i ezaurojmë tek pjesa e fillimit të shqyrtimit të procedimit disiplinor.

{...}: E nderuar Kryetare!

Më falni! Një moment të lutem!

E shpreha fare qartë, me përmbajtjen e shkeljeve për të cilat ndodhem në këtë procedim disiplinor, jam njohur vetëm në procesin e njohjes me materialet e çështjes. Raporti i hetimit nuk është materiali i çështjes, është akt procedural bazë për të cilat magjistrati, nën hetim disiplinor, duhet të ishte i njohur paraprakisht. Materialet janë të tjera gjëra. Të paktën ky është koncepti i ligjit. Në qoftë se ligji nuk parashikon - (po i referohem ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”), është e vërtetë që nuk parashikon sepse e kam vendosur edhe në përmbajtje të shkaktuar ligjor që kam paraqitur kërkesën - nuk parashikon komunikimin e këtij akti, atëherë në ç’mënyrë do komunikohet akti magjistratit. Unë po ju them që deri në datën 22 shtator, relatori i çështjes, zoti Hallunaj, është shumë i informuar që pas kërkesave të përsëritura, kam vënë në dijeni këtë Këshill, që: “Ju po më komunikoni akte procedurale në kuptim të procedurës së zhvillimit të fillimit të hetimit të procedimit disiplinor. Por unë ende nuk jam i njohur për çfarë arsye jam në procedim disiplinor”. Atëherë, përfundimisht kam ardhur, në kuadër të realizimit të të drejtës për njohjen me materialet, kam ardhur dhe kam tërhequr materialet. Kur kam tërhequr materialet, kam konstatuar, në përmbajtje të tyre, edhe raportin e ILD-së, por ky raport nuk më është komunikuar. Në qoftë se unë nuk do e kisha ezauruar të drejtën për njohjen me materialet e çështjes, për njëqind arsye, subjektive, objektive, etj., si do isha njohur me raportin e ILD-së dhe për çfarë arsye ndodhesha në këtë procedim?

Brunilda Kadi: Mundem t’i bëj një pyetje gjyqtarit?

Nga ana juaj po pretendohet që nuk jeni njohur me raportin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përpara se ky procedim të vinte përpara Këshillit.

{...}: Po!

Brunilda Kadi: Nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u pretendua që sipas ligjit, kjo nuk është një e drejtë e juaj në këtë fazë. Pra ai institucion, mbasi e paraqet çështjen pranë Këshillit, nga ky moment e tutje ju keni të drejtë të njiheni dhe me raportin dhe me shkaqet, e dokumentat. Tani, duket dukshëm që nga juve si subjekt në këtë

procedim, që jemi subjekt i posaçëm sepse jeni gjyqtar dhe po interpretoni ligjin, po kështu edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duket dukshëm që ka interpretim të ndryshëm të ligjit. Ju vet mund të referoni dispozitën konkrete për të kundërshtuar pretendimin e ILD-së, që nuk e ka këtë detyrim në këtë fazë që t'ju njohë juve, sepse faktikisht ju sot jeni i njohur, apo jo? Ju ka njohur Këshilli.

{...}: Ju sqaroj.

Jam i njohur në qoftë se akti që unë disponoj është i njëjtë me atë që disponon ILD-ja.

Brunilda Kadi: Ju po supozoni që janë të ndryshme?

{...}: Siç është zhvilluar procedura dhe siç ka përmbajtjen ligji, edhe kjo mund të ndodhë.

Brunilda Kadi: Atëherë, sipas jush, në çfarë dispozite parashikohet e drejta juaj për t'u njohur me raportin, me shkaqet, me të gjithë ato që ju thatë, në fazën kur çështja ndodhet pranë ILD-së? Cila dispozitë e parashikon?

{...}: Faleminderit!

Jam duke folur në kuadër të një procesi të rregullt ligjor.

Sapo e theksova që ligji nuk përmban dispozitë të tillë. Nuk ka. Por procesi i rregullt ligjor ka një logjikë dhe një arsye, pavarësisht se ligji nuk e përmend.

Brunilda Kadi: Dhe juve konkretisht, çfarë e drejtë, në thelb, ju është cenuar?

{...}: E drejta që nuk kam pasur kohën e nevojshme për të realizuar një mbrojtje efektive.

Brunilda Kadi: Atëherë, juve po kërkoni, në thelb, kohë?

{...}: Vetëm në datën 22, për të qenë korrekt para këtij Këshilli, jam përgatitur sa kam pasur mundësi. Por vlerësoj që në rast se për pjesën thelbësore të raportit kam argumente të plota dhe jam i përgatitur, për një pjesë tjetër që është ilustruese për fakte të vogla e rrethana që lidhen vetëm me një pjesë të shkeljeve disiplinore, por që janë të rëndësishme për këtë proces, nuk kam mundur të përgatitem.

Brunilda Kadi: Pra për ta përmbledhur.

{...}: Më janë vënë në dispozicion 2100 faqe – 2400 faqe, kam sjellë 1000 faqe materiale në dispozicion. Përpunimi i të gjithë këtij informacioni, domethënë që nga data

22 shtator (më falni, nuk do e diskutoj më këtë pikë) që kam ardhur personalisht dhe kam tërhequr aktet e këtij procedimi disiplinor, për 6 ditë më është dashur vetëm të mbledh prova për t'i depozituar për llogari të Këshillit dhe për të respektuar detyrimin ligjor, në kuadër të veprimeve paraprake, që brenda datës që më kishte caktuar relatori, zoti Hallunaj, të arrija të depozitoja provat.

Brunilda Kadi: Pra në thelb, ju po thoni që nuk kishit kohë të bënit mbrojtjen. Sepse po ta kishit pasur këtë mundësi që në fazën kur çështja ndodhej përpara ILD-së, ju do ishit...

{...}: Ideja është që në qoftë se çështja do ndodhej përpara ILD-së, unë do isha shumë më i qartë lidhur me rrethanat, faktet dhe çfarë diskutoheshe dhe nuk kisha pse të ndodhesha në një pozicion të tillë, që në rast se nuk vlerësohet që të më jepet kohë, nuk kërkoj kohën në kuptimin, se nuk dua që t'i shmangem këtij procedimi, në asnjë mënyrë, jam përgatitur aq sa jam mundur.

Brunilda Kadi: Flasim për interpretimin e ligjit.

{...}: Por në qoftë se vlerësohet që nuk do më jepet kohë, ju do të konstatoni që kjo kohë është shumë e nevojshme.

Brunilda Kadi: Dhe e fundit. Në shpjegimin që dha ILD-ja, tha që ligji nuk ma vendos këtë detyrim, nuk ia jep këtë të drejtë magjistratit, dhe mbas kësaj ka një filozofi, dhe dha një argument, tha sepse në fakt kështu duhet të ndodhë, dhe dha një argument. Ju keni ndonjë kundër argument për këtë?

{...}: Unë jam gjyqtar i Republikës së Shqipërisë. Edhe në procese penale, për çdo të pandehur, dhe në procese civile, respektoj procedurën. Në proceset penale gjyqi nuk fillon në qoftë se personit nuk i është komunikuar akuza si akt i posaçëm. Kurse në procedurën civile, çdo subjekti të paditur i lihet 30 ditë kohë për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes. Unë nuk po kërkoj 30 ditë kohë, minimalisht 15-ditshin që më njeh ligji, nga momenti i caktimit të seancës.

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Zoti {...}, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, komunikim zyrtar, veç vendimit për fillimin e hetimit disiplinor, me çfarë akti tjetër procedural jeni njohur?

{...}: Jam njohur me zgjatjen e afatit të hetimit disiplinor, që ka lidhje drejtpërdrejt me ankesën kanë paraqitur palët, Inspektorati. Vetëm më janë vënë në dispozicion provat që kishte deri në atë moment Inspektorati në bazë të kërkesës time

Brikena Ukperaj: Pra ju ka vënë në dispozicion edhe provat.

{...}: Mund t’jua citoj.

Mund t’jua citoj, katër-pesë prova janë.

Jam njohur edhe me aktin, ishim me leje dhe më është komunikuar në rrugë sepse ishim në kohën e lejes, që kemi aktin që ju përcillen aktet ju si Këshill i Lartë Gjyqësor dhe thuhet: Drejtuar: Këshilli i Lartë Gjyqësor; Për dijëni: Magjistratit; dhe thuhet: “Bashkëlidhur janë aktet” - Unë akte bashkëlidhur nuk kisha – “dhe raporti”. Unë isha thjesht për dijëni. Pra në momentin që Inspektorati ka përcjellë këto akte, unë nuk kam asnjë lloj dijënie.

Brikena Ukperaj: Nga informacioni që kemi ne në dosje, ka një vendim për përfundimin e hetimit disiplinor, që është vendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i datës 30.07.2020...

{...}: Për këtë po flisnim.

Brikena Ukperaj: ...në të cilin, parashikohet në pikën 3 që, për raportin e përfundimit të hetimit dhe fillimit të procedimit disiplinor, ju njoftohet...

{...}: Jo! –nuk jam njoftuar. Këtu është problemi.

Brikena Ukperaj: Ndërkohë që për materialet e dosjes, e drejta juaj fillon në momentin kur çështja vjen.

{...}: Pra raporti nuk më është komunikuar. Nuk ka qenë bashkëlidhur.

Brikena Ukperaj: Ju keni pasur të drejtë për t’u njohur me materialet e dosjes, dhe ajo ka një logjikë, por ama ka pasur edhe Inspektori dhe ju të drejtën që t’ju njoh me raportin e mbylljes së hetimit disiplinor.

{...}: Nuk ka qenë bashkëlidhur atij akti që më është drejtuar për dijëni.

Brikena Ukperaj: Nga aktet që kemi rezulton që ai ju është njoftuar në fakt raporti i mbylljes bashkë me relacionin përkatës.

{...}: Atëherë, më lejoni t'ju them ose ta provoj faktin që nuk më është komunikuar.

Brikena Ukperaj: Nuk ju është komunikuar.

{...}: Shkresa... jam vënë në dijeni nga kryetarja e gjykatës dhe zarfi ishte tmerrësisht shumë i hollë. Pra kishte vetëm dy fletë. Normalisht, ajo është direkt personi që më ka komunikuar për ardhjen e kësaj shkrese.

Unë po them edhe një gjë, unë po marrë përsipër - mos më keqkuptoni ju lutem, kjo është shumë e rëndësishme, në realizimin e mbrojtjes time – jam magjistrat prej 26 vitesh dhe jam këtu për shkarkim, pra duhet të jem shumë serioz në lidhje me këtë.

Brunilda Kadi: Zoti gjyqtar, nëse subjekti në këtë procedim thotë që s'jua kam njoftuar, s'ka nevojë që ta provoni.

{...}: Unë po deklaroj e nderuar anëtare që këtë akt unë e kam marrë. Në fakt nuk kam firmosur në asnjë vend. Pra unë nuk po mbrohem me faktin që nuk provohet që më është komunikuar. Unë e kam marrë, ju thashë edhe rrethanat si e kam marrë. Por raport bashkëlidhur, siç thuhet, nuk ka.

Brunilda Kadi: Dakord!

Nga ana e ILD-së thuhet që ju nuk ju është komunikuar raporti, kështu që... Vendimi, jo raporti.

{...}: Kjo është edhe arsyeja që kam mbështetur ankesat në drejtim edhe të ILD-së dhe të KLGJ-së, nga ky koncept. Pra në qoftë se ILD nuk e ka për kompetencë, se ligji s'e ka, i bie që as KLGJ-ja nuk e ka. Në ç'mënyrë do njihem unë me të? Kjo është pyetja. Si do njihem unë me përmbajtjen e akteve? Pra me akuzën, le të themi, me akuzën. Ky është problemi.

Dritan Hallunaj: Nëse mundem.

I nderuar gjyqtar, në momentin që dosja ka ardhur në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nga ana e Komisionit janë bërë të gjitha veprimet që ka rregullorja në zbatim të ligjit, dhe nga ana jonë ju janë njoftuar ato akte që njoftohen. Pra ju jeni njohur dhe keni ardhur keni marrë një kopje të të gjitha akteve. Është e vërtetë kjo?

{...}: Po! – absolutisht, e pohova.

Dritan Hallunaj: Sa i përket pastaj pjesës tjetër nëse ka akte të tjera, ne këtu e kemi përfaqësuesin e ILD-së dhe mund të themi nëse ka akte të tjera përveç atyre që janë paraqitur dhe që është njohur gjyqtari.

Artur Metani: Jo!

Dritan Hallunaj: Nuk ka akte të tjera.

Atëherë, më lejoni që aktet që kanë qenë këtu, t'ia servirim edhe një herë ILD-së, ato dy fashikujt aty mbrapa. Meqenëse kanë ardhur origjinalet dhe tek origjinalet nuk ka gjë tjetër tej asaj që ka atje.

Artur Metani: Nuk ka asgjë tjetër veç asaj që është dërguar fillimisht.

Dritan Hallunaj: Atëherë, punonjësi mund t'ia serviri ato dy fashikuj, mund t'ia vendosim në dispozicion Inspektorit. Pra thjesht janë fashikuj që jeni njohur por që ishin fotokopje të noterizuara.

Artur Metani: Besoj për magjistratin, se unë jam i qartë për dosjen.

Dritan Hallunaj: Dakord! Ne e kemi detyrimin që t'ju kthejmë ato, meqë po mbajmë origjinalin. Për këtë them.

Artur Metani: Në rregull!

Dritan Hallunaj: Pra në këto momente magjistrat, jeni në gjendje të vazhdoni mbrojtjen? Kërkoni kohë për të përgatitur, pasi në fillim thatë që jeni njohur me një pjesë dhe keni kaluar rreth 1000 e ca faqe. Pra për pjesën tjetër, jeni njohur, të vazhdojmë seancën dëgjimore apo jo?

{...}: Edhe një herë. Koncepti im është kështu.

Thash, jam shumë i gatshëm dhe nuk i shmangem fare këtij procedimi disiplinor, por kam bërë pjesën kryesore, e çmoj shumë të nevojshme edhe për pjesët e tjera sepse ilustron qëndrimi im tek pjesa kryesore. Por ka edhe diçka tjetër në këtë mes. Pra mund të parashtoj pjesën kryesore dhe të kërkoj kohë për pjesën tjetër. Prandaj kjo është në vlerësimin tuaj. Kam parashtruar edhe faktin lidhur me kërkesën për kthimin e akteve, për thirrjen me cilësinë e dëshmitares Ministres së Drejtësisë dhe administrimin e një sërë dokumentash të tjera. Kjo lidhet me mënyrën se si do vazhdojmë.

Dritan Hallunaj: Për sa i përket kësaj pjese, ju jeni edhe gjyqtar vet dhe e dini momentin procedural se kur duhet dhe kur bëhet një kërkesë dhe kur jo, - sipas rregullores që ka Këshilli. Në vijim të asaj që po them, nga ana e Komisionit do t'i propozohet Këshillit me relacion, pra i është propozuar, pra kanë ardhur në dijeni anëtarët, propozimi i Këshillit për kërkesat që ju keni bërë, por kjo i përket pastaj një faze tjetër, mendoj unë, që është faza pasi të jetë deklaruar e hapur seanca dëgjimore, shqyrtimi i seancës dëgjimore dhe pastaj kërkesa për provat dhe pas kësaj mund të merrni përgjigje me vendimmarrjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit. Nga ana e Komisionit është kryer detyrimi ynë, pasi ne ia kemi servitur propozimin tonë me akt të gjithë anëtarëve të Këshillit. Por do jetë gjithmonë Këshilli që do vendosë dhe për mendimin tim, kjo do jetë në fazën kur të bëhet kërkesa për prova, pra tej fazës së verifikimeve apo legjitimitetit.

{...}: Meqenëse ligji dhe rregullorja paraqesin disa pasaktësi, një konfuzion konceptesh (nga perceptimi im si gjyqtar), nuk arrij dot, nuk e kuptova. Mbarojmë fazën e kërkesave paraprake. Deklarojmë të hapur shqyrtimin. Parashtron i nderuari zoti Inspektor. Parashtror unë.

Dritan Hallunaj: Do merret vendim për çdo kërkesë tuajën dhe të Inspektorit për marrjen e provave.

{...}: Po pastaj, pas marrjes së provave, fillon shqyrtimi gjyqësor?

Ky është shqyrtimi.

Dritan Hallunaj: Të paktën sipas ligjit kështu është. Atëherë do jetë ajo pjesa tjetër.

{...}: E lë në vlerësimin tuaj të gjithë këtë situatë, vetëm ju specifikoj se unë nuk kam pasur njohje me raportin e ILD-së.

Brikena Ukperaj: Jeni në gjendje të realizoni mbrojtjen tuaj sot?

{...}: Unë jam në gjendje të realizoj deri në një nivel të caktuar mbrojtjen time. Për pjesën time nuk kam pasur kohë. Në qoftë se ju vlerësoni që deri në atë nivel ku kam shkuar ta parashtror, po e parashtror.

Naureda Llagami: Atëherë, nga ana e Këshillit do vlerësohet kërkesa juaj.

Fatmira Luli: Në momentin që jeni paraqitur pranë anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për t’u njohur me dosjen, keni ngritur këto pretendime që shkresa njohëse ju ka ardhur pa materialet shoqëruese?

{...}: Po! – një ditë përpara se të njihesha.

Domethënë, më datë 21 shtator 2020 kam ngritur këtë pretendim me kërkesë procedurale, me kërkesë.

Fatmira Luli: E keni bërë shënimin në momentin që jeni njohur me dosjen, që mua këto akte po më vihen tani për herë të parë dhe raporti nuk më është bërë i njohur?

{...}: Normal është mbajtur inventar dhe procesverbal mbi inventarin në momentin kur jam njohur.

Fatmira Luli: Një sekondë. Inventari është gjë tjetër. Çfarë kishte dosja që ju kanë vënë në dispozicion anëtari i Komisionit të Disiplinës, është gjë tjetër. Ju, këto pretendime që ngrini sot për ILD-në, i keni parashtruar në momentin që ju janë vënë këto?

{...}: Jo! – i kam parashtruar një ditë para se të marrë aktet.

Fatmira Luli: Një ditë para? Para se të njihesh me dosjen?

{...}: Po! –sepse nuk po njihesha dhe nuk dija se çfarë po ndodhte.

Fatmira Luli: E ke depozituar me shkrim këtë kërkesë.

{...}: Po! –është shkresa me nr. 2 prot., datë 21 shtator 2020, është depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, një ditë para se të vija të njihesha me aktet.

Brunilda Kadi: Është një moment procedural, zoti gjyqtar, duhej apo s’duhej ILD-ja t’jua kishte njoftuar raportin, dhe është ky diskutimi i ligjit; dhe momenti tjetër është që faktikisht çfarë ju është cenuar dhe ju thatë që s’kam pasur kohë të mjaftueshme.

Atëherë, çfarëdo që të vendosi për momentin e parë, ajo ka kaluar në kohë, qoftë sikur Këshilli të konstatojë që ILD-ja duhet t’jua kishte njoftuar raportin dhe kjo do shërbejë edhe si precedent për rastet e tjera, meqenëse ky është edhe rasti i parë me legjislacionin e ri për procedimet disiplinore, në fund të ditës diskutimi është që juve pretendoni që ju është cenuar dhe s’keni pasur “de facto” kohën e mjaftueshme për t’u përgatitur, që do të thotë që edhe në këtë moment, duhet të marrim në konsideratë

kërkesën tuaj dhe të vendosim në lidhje me kohën. Juve keni nevojë për kohë në këtë moment dhe kërkoni që t'ju jepet kjo kohë. Sa është kjo koha që ju nevojitet?

{...}: Për të qenë i sinqertë, dhe mund të verifikohet nga kushdo, pasi kam përfunduar pjesën që kam mundur të analizoj, dhe ky është një proces ditë-natë, kam kërkuar që minimalisht 5 ditë kohë për pjesën tjetër. Minimalisht 5 ditë.

Brunilda Kadi: Pra sot kërkoni shtyrje minimalisht 5 ditë.

{...}: Meqenëse e kuptoj se si është situata normal procedurale, për gjithë sa parashtrova, i paraqes kërkesën Këshillit të Lartë Gjyqësor për të më dhënë kohën e nevojshme për të përfunduar mbrojtjen në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, por nga këndvështrimi që nuk i shmangem procedimit, pra nuk po bëj një kërkesë fiktive lidhur me këtë situatë. Mund ta vërtetoj që jam përgatitur.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, mund të largoheni nga salla.

Artur Metani: Kam edhe një koment, të lutem, nëse mundem!

Proceduralisht, mendoj që kërkesa është abuzive sepse magjistrati ka qenë në dijeni të çdo hapi të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, siç e thash në fillim, që në datën 2 prill, kur është bërë njoftimi për fillimin e hetimit të procedimit disiplinor, dhe kjo provohet edhe nga kthimi i përgjigjes nga magjistrati në datë 28 prill 2020 dhe më pas magjistratit i janë dërguar të gjitha provat që ILD-ja ka pasur. I mëshoj edhe një herë faktit që ILD-ja nuk e ka detyrim ligjor, siç u provua edhe pas pyetjes së drejtpërdrejtë se kush është detyrimi ligjor i ILD-së për të dërguar përfundimin e hetimit dhe raportin. Detyrimi i ILD-së është të njoftojë magjistratin sipas nenit 129 “3. ... vendimi për arkivimin, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit...”. Kështu që i kërkoj Këshillit të mos e zgjasë këtë afatin sepse është i pabazuar ligjërisht.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ju ftoj që të largoheni nga salla për t'i lënë mundësi Këshillit që të marri vendim lidhur me kërkesën e bërë nga subjekti.

(Dalin nga salla e mbledhjes magjistrati, z. {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Periand Teta. Vijohet diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve. Pas diskutimeve nga anëtarët, rihyjnë në sallën e mbledhjes palët.)

Naureda Llagami: Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi kërkesën e parashtruar nga magjistrati z. {...}, vendosi: Pranimin e kërkesës së magjistratit për shtyrjen e seancës dëgjimore në datë 14 tetor, ora 11:00, për t'i dhënë kohën e mjaftueshme për të realizuar një mbrojtje efektive.

{...}: Faleminderit!

Me kaq, seanca dëgjimore mbyllet.

Artur Metani: Faleminderit!

(Dalin nga salla e mbledhjes magjistrati, z. {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Periand Teta.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.10.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:06 dhe mbaroi në orën 11:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 12. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 13. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 14. Medi Bici | (anëtar) |
| 15. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 16. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 17. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 18. Ilir Toska | (anëtar) |
| 19. Alban Toro | (anëtar) |
| 20. Brikena Ukperaj | (anëtar) |

21. Marçela Shehu (anëtare)

22. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë”.

Naureda Llagami: Atëherë, vazhdojmë me rendin e ditës. Çështja që është në shqyrtim bëhet fjalë për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit, Kryetare!

Parashtroj relacionin për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Pranë Këshillit të Lartë në datë 24.09.2020, me shkresën nr.4619 prot., është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, dhe nenin 138 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga nenet 104, pika 3 dhe 111 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit {...}, të masës disiplinore "Shkarkim nga detyra", të parashikuar nga neni 111 i Ligjit "Për Statusin".

Rrethanat e faktit - Këshilli me shkresën nr.2067/5 prot., datë 11.05.2020, i ka përcjellë për trajtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo praktikë është regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.664 prot., datë 12.05.2020. Nga kjo praktikë ka rezultuar se:

Me vendimin nr.129, datë 27.11.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është vendosur: "Deklarimi fajtor i të pandehurit {...} për veprën penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", të parashikuar nga neni 319/ç të K.Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet dhe 9 muaj burgim. Në bazë të nenit 406/1 të K.Pr.Penale të pandehurit {...} dënohet me 2 vjet dhe 6 muaj burgim. Vuajtja e dënimit të pandehurit i fillon nga dita e ndalimit, datë 09.11.2017 dhe të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme. Heqjen e së drejtës të të pandehurit {...} për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 3 vjet, bazuar në nenin 35/2 të K.Penal.

Mbi ankimin e të pandehurve, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.18, datë 27.02.2019, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr.129, datë 27.11.2018 të Gjykatës për Krime të Rënda dhe ndër të tjera në lidhje me masën e dënimit për të pandehurin {...} e ka dënuar atë me 3 vite burgim. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale është dënuar me 2 vite burgim. Lënien në fuqi për pjesën tjetër të vendimit.

Më datë 11.03.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka nxjerrë Urdhrin “Për ekzekutimin e vendimit penal nr.18, datë 27.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë për të dënuarin {...}”, duke urdhëruar Këshillin e Lartë Gjyqësor për ekzekutimin e dënimit plotësues, të caktuar në këtë vendim, të “heqjen e të drejtës të të pandehurit për të ushtruar funksione publike”, parashikuar nga neni 35/2 i Kodit Penal.

Në datë 09.04.2019, nga ana e përfaqësuesit të të dënuarit {...}, është depozituar rekursi ndaj vendimit nr.18, datë 27.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Mbi bazën e tyre çështja është regjistruar në Gjykatë të Lartë me nr. Akti 0492/19 .

Me vendimin nr.664/4 prot., datë 07.07.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj gjyqtarit {...}”, Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka vendosur fillimin e procedimit disiplinor.

Shkeljet disiplinore të pretenduara nga inspektori i lartë të drejtësisë, objekt i procedimit disiplinor, të verifikuara gjatë fazës së hetimit disiplinor-

Në raportin e hetimit pretendohet se nga përmbajtja e vendimit gjyqësor të formës së prerë rezulton se gjyqtari {...}, është deklaruar fajtor veprime të parashikuara nga neni 319/ç i Kodit Penal si vepër penale. Në këtë vendim argumentohet se: “....Pas kryerjes së veprimeve hetimore me urdhër të prokurorit datë 26.10.2017 në regjistrin e njoftimit të veprave penale regjistrohet edhe emri i gjyqtarit {...} dhe shtetasve të tjerë. Çështja penale në ngarkim të të pandehurit {...} është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë në datë 17.10.2016, ku një ndër anëtarët e trupës gjykuese që do të gjykonin këtë çështje ishte edhe gjyqtari {...}. Janë lejuar përgjimet e komunikimeve telefonike të numrit celular përkatës, që i pandehuri {...} përdorte nga IEVP Fushë Krujë, të numrit në përdorim të të pandehurit dhe të bashkëpandehurve të tjerë, si dhe të pandehurit {...}. Me kërkesë të prokurorit me vendimin nr. 282, datë 09.11.2017 është lejuar kryerja e

kontrollit të banesës, të zyrës dhe kontrollit personal të të pandehurit {...} pasi dyshohej se mund të gjendeshin shuma monetare të pajustificuara që kishin lidhje me faktin penal objekt gjykimi. Nga procesverbali i kontrollit dhe sekuestrimit rezulton se në banesën e të pandehurit {...} janë gjetur dhe sekuestruar si provë material shumat “cash” prej 174.810 euro, 1000 USD, si dhe 9.605.000 lekë, të cilat janë gjetur në një nga dhomat në një valixhe të vogël, ndërsa në një dhomë tjetër janë gjetur edhe 544.000 lekë.

Gjykata e Apelit, në vendimi e saj, ka argumentuar se: “Së pari, sipas porosisë të të pandehurit në procedim të lidhur i cili ndodhej në IEVP Fushë-Krujë në pritje të gjykimit të çështjes penale ndaj tij, i pandehurit në procedim të lidhur.. bashkëpandehurve të tjerë pra, i kanë dorëzuar të pandehurit tjetër në një lokal në Fushë Krujë shumën prej 30.000 euro; Së dyti, Kolegji krijon bindjen e plotë se qëllimi i dhënies së shumës prej 30.000 euro ishte që të përdorej për të ndikuar në gjykimin që zhvillohej ndaj të pandehurit {...} në Gjykatën e Apelit Tiranë. Pra të pandehurit si dhe familjarët e tyre kanë qenë në dijeni paraprakisht për vendimmarrjen e gjykatës së apelit për shkak të shumës së parave që ata kanë dhënë; Së katërti, Kolegji ashtu si dhe gjykata e shkallës së parë krijon bindjen se shuma prej 30.000 euro i është dhënë të pandehurit {...} nga i pandehuri {...} vet apo nëpërmjet ndonjë personit tjetër, me qëllim që të favorizohej në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë i pandehuri, në kushtet kur i pandehuri {...} ishte anëtar i trupës gjykuese që gjykonte atë çështje...”.

Procedura e verifikimit paraprak të kërkesës për fillimin e procedimit -

Bazuar në nenin 31 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, në cilësinë e Relatorit të çështjes, u kryen verifikime mbi ekzistencën e rasteve të parashikuara nga neni 139 të Ligjit “Për Statusin”, të cilat çojnë Këshillin drejt vendimmarrjes për mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar seancë dëgjimore. Këto raste janë të parashikuara në mënyrë shteruese në ligj, si vijon:

a) Nëse shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të Ligjit “Për Statusin”. Sipas këtij neni shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit. Në çdo rast afati i parashkrimit fillon nga momenti kur

shkelja e pretenduar është kryer. Pavarësisht këtyre parashikimeve, për shkeljet disiplinore që përbëjnë njëkohësisht vepra penale, afatet e parashkrimit përllogariten sipas parashikimeve të Kodit Penal, vetëm nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet. Sipas të dhënave në dosjen hetimore dhe në raportin e hetimit, rezulton se:

i. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor, me iniciativë të tij, më datë 07.07.2020 .

ii. Shkelja disiplinore e pretenduar përbën njëkohësisht vepër penale, sipas nenit 319/ç të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, nen i cili parashikon dënimin me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Sa më lart parashtruar, arrij në përfundimin se afati i parashkrimit për shkeljen disiplinore të pretenduar është 10 vjet, referuar parashikimeve të nenit 66/1 të Kodit Penal dhe fillimi i hetimit disiplinor me iniciativë është vendosur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë brenda këtij afati parashkrimi.

b) Nëse çështja ka qenë objekt i një procedimi disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë.

Nga verifikimet e kryera dhe të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezulton se shkelja e pretenduar, të ketë qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor, të zgjidhur me vendim të formës së prerë.

c) Nëse ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, geramat “ç” dhe “d” të Ligjit “Për Statusin”. Sipas këtij neni parashikohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin disiplinor, nëse provohet se rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

i. magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të Ligjit “Për Statusin” ose

ii. nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të Ligjit “Për Statusin” ose

iii. magjistrati ka vdekur.

Sa referuar, konstatoj se nga verifikimet e kryera dhe nga të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezultoi e provuar ekzistenca e një prej shkaqeve ligjore si më lart cituar.

ç) Nëse raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor është depozituar raporti i hetimit i përgatitur nga Inspektore Marsela Pepi dhe miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 3 e Ligjit “Për Statusin” .

Referuar këtij parashikimi ligjor, arrij në përfundimin se raporti i hetimit është depozituar i arsyetuar në të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë.

Në kushtet kur nuk ndodhemi në një nga rastet e parashikuara në ligj për mbylljen e procedimit disiplinor, Këshilli duhet të vendosë kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm në seancë dëgjimore dhe të caktojë datën për seancën e parë dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda 1 muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra datë 24.09.2020. Në caktimin e datës së seancës dëgjimore Këshilli duhet të mbajë në konsideratë edhe afatin 15-ditor të njoftimit të palëve për datën e seancës dëgjimore, sipas parashikimeve të nenit 138 të Ligjit “Për Statusin.

Përfundimisht, në cilësinë e relatorit, mbështetur në nenin 147/a pika 1, germa b) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 138, pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 31, pika 1 dhe 2 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Komisioni i propozon Këshillit: Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë dëgjimore; Caktimin e datës për zhvillimin të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për këtë, ne si Komision, pasi kam paraqitur një kërkesë pranë Komisionit ku kemi arritur në këtë konkluzion, si dhe është edhe projektvendimi që kemi përpiluar sa i përket caktimit të seancës dëgjimore nëse Këshilli do vendosë.

Data 24 është data që plotësohet muaji. Duhet të jetë edhe 15-ditëshi që vet palët duhet të kenë në dispozicion për mbrojtjen.

Naureda Llagami: Atëherë, keni ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nga ana e relatorit u propozua data 20, ora 11:00. Jemi dakord?

Kalojmë në votim projekt-aktin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi caktimin e datës 20, ora 11:00 si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit {...} brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor